



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **“SHËRBIME KARROCERIE”**

**Niveli III në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit III të KEK<sup>2</sup>**

**M4-III-23**

Tiranë, 2023

---

<sup>1</sup>Korniza Shqiptare e Kualifikimit

<sup>2</sup>Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Shërbime karrocierie			Kodi M4-III-23
	Kohëzgjatja	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi i kualifikimit profesional “Shërbime karrocierie”, Niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për riparimin mirëmbajtjen dhe shërbimet në strukturat mbajtëse, shasitë, karrocieritë dhe kabinat e automjeteve, si dhe të <i>zhvillojë aftësitë profesionale dhe personale të individit.</i>			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Shërbime karrocierie” Niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë mbaruar dy vitet e para në arsimin profesional, “Shërbime mjeteve transporti”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK;</li> <li>- janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të kualifikimit profesional.</li> <li>- mund të pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë e tyre.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime karrocierie”, Niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale të nivelit dhe Suplementin përkatës të saj, si punonjës i kualifikuar në këtë kualifikim.</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t'i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të shërbimeve të mjeteve të ndryshme të transportit, në serviset e riparimit të mjeteve të ndryshme të transportit të cilat kanë nevojë për riparim karrocierie, të punësohet në pikat e shitjeve të pjesëve të këmbimit të automjeteve.</p> <p>Me përfundimin e arsimimit të kualifikimit profesional “Shërbime karrocierie”, niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individit ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin IV të KSHK-së, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/manaxherial) të kualifikimit profesional (njëvjeçar) dhe fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
<b>Data e validimit</b>	<i>Korrik 2023</i>			
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	<b>M-II-04-11, M4-III-18</b>			

# **STRUKTURA E KUALIFIKIMIT:**

**Rezultatet e të nxënit në:**

## **NJOHURI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime karrocierie” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

### **Planifikimi dhe organizimi i punës**

- Të shpjegojë rëndësinë e shërbimeve në karrocieri në mjetet e transportit;
- Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e një servisi për shërbime karrocierie;
- Të përshkruajë organizimin dhe ndarjen e punës në një servis për shërbimet e karrocierisë të mjeteve të transportit;
- Të listojë shërbimet e karrocierisë në mjetet e transportit duke argumentuar rëndësinë e tyre;
- Të klasifikojë shërbimet e karrocierisë në mjetet e transportit;
- Të shpjegojë rëndësinë e konsultimit dhe koordinimit me teknikë të tjerë;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore sipas proceseve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimit dhe sistemimit të vendit të punës;
- Të listojë llojet e mjeteve, veglave dhe pajisjeve në shërbime karrocierie, funksioni dhe përdorimi i tyre;
- Të listojë llojet e materialeve dhe pjesëve të këmbimit, funksioni dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e sigurimit të veglave, mjeteve të punës dhe pajisjeve sipas proceseve të punës;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes paraprake të kohës së riparimit;
- Të përshkruajë veprimet për sigurimin e bazës materialo-teknike për shërbimet e karrocierisë në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë procedurat për kontrollin paraprak të mjetit dhe për pranimin e tij në servis;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së detyrave në ekip.
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullores së brendshme.

### **Parapërgatitja e vendit të punës**

- Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së veglave, mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas proceseve përkatëse;
- Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së materialeve, pjesëve të këmbimit dhe aksesorëve duke përdorur programet elektronike dhe katalogët përkatës;
- Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së vendit të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të manualeve të përdorimit të mjeteve të punës dhe pajisjeve ndihmëse në shërbime karrocierie;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit për gatishmërinë e mjeteve për punë;
- Të shpjegojë mënyrat e vendosjes së sigurt të automjetit në postin e punës;

- Të shpjegojë rëndësinë e stakimit të burimit të energjisë së automjetit para fillimit të procesit të riparimit.

### **Kontrolli paraprak në karrocerinë e automjeteve**

- Të përshkruajë rëndësinë dhe procedurat e kontrollit paraprak në karroceri;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të burimeve të informacionit për shërbimet në karroceri;
- Të listojë llojet e dokumentacionit teknik për shërbimet në karroceri;
- Të listojë parregullsitë kryesore në karroceri, si dhe procedurat e kontrollit paraprak të saj;
- Të shpjegojë kontrollet paraprake dhe matjet e nevojshme për shërbimet në karroceri;
- Të përshkruajë mënyrën e përcaktimit të shkallës së dëmtimit të pjesëve të karrocerisë;
- Të përshkruajë rëndësinë e konsultimit me instruksionet e prodhuesit për shërbimet në karroceri;
- Të përshkruajë llojet e shasive sipas materialeve përbërëse dhe veçorive konstruktive të tyre;
- Të përshkruajë kontrollin paraprak dhe përcaktimin e parregullsive të aksesorëve në karroceri;
- Të listojë instrumentet dhe aparatet matëse për kontrollin e aksesorëve të karrocerisë.

### **PUNIME (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) NË SHËRBIMET E KARROCERISË TË MJETEVE TË TRANSPORTIT**

#### **Të përgjithshme:**

- Të listojë llojet e punimeve në karroceri;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të standardeve sipas manualeve të prodhuesit në shërbimet në karroceri;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e çmontim/montimit të elementeve përbërës të karrocerisë në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e zëvendësimit të elementeve përbërës të karrocerisë në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e riparimit me prerje, ngjitje, bashkim, saldim, stukim dhe lyerje, me pajisjet dhe mjetet përkatëse.

#### **1. Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në shasinë e mjeteve të transportit**

- Të përshkruajë radhën e punës për çmontimin dhe montimin e pjesëve xhenerike për realizimin e punimeve në shasitë e automjeteve;
- Të përshkruajë procesin e kontrollit dhe matjes së shkallës së deformimit të shasisë;
- Të përshkruajë hapat për drejtimin/riparimin e mundshëm të shasisë së deformuar;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për të realizuar lyerjen e pjesëve të riparuar të shasisë;
- Të përshkruajë përzgjedhjen e instrumenteve dhe veglave të punës për lyerjen e pjesëve të riparuar të shasisë;
- Të përshkruajë procesin e përzgjedhjes së bojës dhe materialeve të nevojshme për pastrimin dhe lyerjen e sipërfaqeve metalike të shasisë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e shasisë së automjeteve;

- Të përshkruajë proceset e kontrollit përfundimtar për punimet e kryera në shasi.

## **2. Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në kabinë**

- Të përshkruajë procesin e kontrollit dhe përcaktimin e shkallës së dëmtimit të kabinës;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të llamarinës në kabinë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të prerjes së pjesës së dëmtuar në kabinë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të saldimit në kabinë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të lidhjes ose bashkimit në kabinë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të stukimit dhe lyerjes së pjesëve të riparuarra të kabinës;
- Të përshkruajë procedurat e punimeve për zëvendësimin e kabinës së automjeteve;
- Të përshkruajë proceset e kontrollit përfundimtar për punimet e kryera në kabinë.

## **3. Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në elementet e çmontueshme të kabinës**

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në dyert e automjeteve;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në parafango;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në mbulesën e motorit (kofano) dhe të bagazhit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në parakolp, mbrapakolp dhe maskarino;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të fenerëve, stopave, sinjaleve;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit/zëvendësimit të pasqyrave;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të xhamave të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e punimeve të riparimit/zëvendësimit të mekanizmit të ngritjes së xhamave;
- Të përshkruajë procedurat e punimeve të riparimit/zëvendësimit të mekanizmit të fshirjes së xhamave;
- Të përshkruajë procedurat e punimeve të zëvendësimit të gominave izoluese të kabinës;
- Të përshkruajë proceset e kontrollit përfundimtar për punimet e kryera në elementët e çmontueshëm të kabinës.

## **4. Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në pjesët e brendshme të kabinës**

- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të kroskotit;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të airbag-ut;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të rripave të sigurimit;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit/zëvendësimit të sediljeve (ndenjëseve);
- Të përshkruajë procedurat e riparimit/zëvendësimit të veshjes së brendshme të automjetit;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit/zëvendësimit të aksesorëve të brendshëm;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit/zëvendësimit të baxhasë;
- Të përshkruajë proceset e kontrollit përfundimtar për punimet e kryera në pjesët e brendshme të kabinës.

## **5. Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në aksesorët e karrocërisë dhe të kabinës**

- Të përshkruajë procedurat e riparimit/zëvendësimit të bravave të automjetit;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit/zëvendësimit të dorezave të dyerve;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit/zëvendësimit të menteshave të dyerve;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit/zëvendësimit të fshirëseve të xhamave;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit/zëvendësimit të antenave;
- Të listojë llojet e regjistrimeve të aksesorëve të kabinës;
- Të përshkruajë proceset e kontrollit përfundimtar për punimet e kryera në aksesorët e kabinës.

### **Stukimi, smerilimi, lyerja dhe luçidimi**

- Të përshkruajë procesin teknologjik për të realizuar lyerjen e pjesëve të karrocerisë;
- Të përshkruajë mënyrën e përcaktimit dhe kontrollit të sipërfaqeve të karrocerisë për smerilim, stukim, lyerje dhe luçidim me instrumentet përkatës;
- Të përshkruajë teknikat e smerilimit, stukimit, lyerjes e luçidimit të sipërfaqeve të dëmtuara të karrocerisë;
- Të përshkruajë mënyrat e pastrimit të sipërfaqeve para lyerjes me materialet përkatëse;
- Të shpjegojë manualët e bojërave dhe rëndësinë e përzgjedhjes së bojës;
- Të shpjegojë teknikat e izolimit të pjesëve që nuk do të lyhen;
- Të shpjegojë rëndësinë e parapërgatitjes së furrës për lyerje;
- Të shpjegojë teknikat e lyerjes dhe regjimit të pjekjes;
- Të shpjegojë teknikat e kontrollit të defekteve pas lyerjes dhe mënyrat e riparimit të tyre.

### **Shërbime mirëmbajtje të pjesëve të karrocerisë në mjetet e transportit**

- Të listojë llojet e mirëmbajtjes së karrocerisë duke argumentuar rëndësinë e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të informacionit nga burime të ndryshme, manualët e prodhuesit si dhe programet e nevojshme për shërbimet e mirëmbajtjes karrocerisë etj.;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes të elementëve të karrocerisë;
- Të përshkruajë llojet e pastrimeve, mënyrat dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në lidhjet, bashkimet dhe regjistrimet e pjesëve në karroceri;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në luçidimin e pjesëve në karroceri;
- Të përshkruajë materialet për mirëmbajtjen në pjesët e karrocerisë;
- Të listojë llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes së aksesorëve të kabinës.

### **Sipërmarrje dhe edukim karriere**

- Të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes së biznesit;
- Të përshkruajë planin për hapjen e një biznesi të vogël për shërbimet e karrocerisë për mjetet e transportit;
- Të përshkruajë nevojat dhe mënyrat e plotësimit të kërkesave të klientëve;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të çmimit të tregut lidhur me materialet, pajisjet e punës dhe pjesët e këmbimit si dhe shërbimeve të kryera;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së kostos së materialeve të punës, pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të kryera;
- Të shpjegojë mënyrën e hartimit të planeve ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;

- Të shpjegojë detyrimet tatimore, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën që lidhet me aktivitetin e kryer;
- Të përshkruajë mënyrën dhe formatet e përgatitjes së raporteve periodike për shërbimet;
- Të përshkruajë mënyrën e pasqyrimin të të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara për klientët në regjistrat e duhur;
- Të listojë mënyrat e pagesave për shërbimet e kryera;
- Të rendisë mënyrat e përgatitjes së një oferte për punimet/shërbimet që do të kryhen;
- Të shpjegojë mënyrat e furnizimit me bazë materialeve dhe pajisje të nevojshme;
- Të përshkruajë mënyrën e plotësimit të dokumentacionit teknik dhe financiar për shërbimet e kryera në pjesët e karrocierisë;
- Të shpjegojë mënyrat e ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit;
- Të listojë hapat e veprimeve me institucionet financiare;
- Të përshkruajë rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe nevojën e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore për shërbime karrocierie në mjetet e transportit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit të njohurive për aplikimin e teknikave e reja në punë;
- Të shpjegojë rëndësinë e nevojave për trajnim të vazhdueshëm;
- Të shpjegojë rëndësinë e pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me ngritjen profesionale të tij;
- Të përshkruajë metodat dhe kriteret e vlerësimit të performancës.

### **Komunikimi dhe etika profesionale**

- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe teknikat përkatëse të tij;
- Të përshkruajë rëndësinë e shkëmbimit të informacionit mbi problemet dhe të rejtat e ditës;
- Të shpjegojë parimet dhe rëndësinë e domosdoshmërisë së punës në grup;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të hierarkisë;
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e kodit të etikës dhe zbatimit të tij;
- Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës;
- Të shpjegojë teknikat e zgjidhjes së ankesave;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të TIK dhe teknologjive të reja të komunikimit;
- Të respektojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në veprim dhe komunikim.

### **Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit**

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;



- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të manualeve të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas Standardit në fuqi;
- Të përshkruajë masat për garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të listojë llojet e aksidenteve gjatë veprimtarisë së kryerjes së shërbimeve të karrocërisë në mjetet e transportit dhe mënyrën e shmangies së tyre;
- Të listojë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të shpjegojë elementët e sinjalistikës të vendosura në mjediset e punës;
- Të përshkruajë planin dhe procedurat e evakuimit në raste emergjence;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Të përshkruajë rregullat e përdorimit të pajisjeve të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH).
- Të përshkruajë rreziqet në ambientet me gaz, me energji elektrike, me materialet ndezëse etj.;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me vegla dhe pajisje me energjinë elektrike;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve dhe zhvendosjeve të ngarkesave dhe pesha të rënda;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me pajisje fikse dhe të lëvizshme;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik të ruajtjes, magazinimit dhe punimeve me lëngje të ndryshme (vaj, alkool, lëndë djegëse, bojë, solucionet kimike etj.);
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre;
- Të përshkruajë parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të përshkruajë procedurat e duhura për ndarjen e mbetjeve sipas llojit dhe depozitimin e mbetjeve nga procesi i punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit racional të lëndëve të para, veglave të këmbimit dhe të energjisë;
- Të përshkruajë zbatimin e protokolleve të duhura në raste pandemie.

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime karrocërie” niveli III, individi duhet të jetë i aftë të:

### **Planifikimi dhe organizimi i punës**

- Të kryejë shërbime në karrocëri në mjetet e transportit;
- Të organizojë ndarjen e punës në një servis për shërbimet e karrocërisë të mjeteve të transportit;
- Të koordinojë punën me specialistë dhe teknikë të tjerë;
- Të planifikojë dhe menaxhojë burimet njerëzore sipas proceseve të punës;
- Të organizojë dhe sistemojë vendin e punës;
- Të përdorë materialet dhe pjesët e këmbimit sipas funksionit;
- Të kryejë llogaritje paraprake të kohës së riparimit;
- Të realizojë kontrollin paraprak të mjetit për pranimin e tij në servis;
- Të ndajë detyrat në ekip;
- Të zbatojë rregulloren e brendshme.



### **Parapërgatitja e vendit të punës**

- Të organizojë vendin e punës për shërbimet e karrocërisë;
- Të përzgjedhë veglat, mjetet, pajisjet dhe makineritë sipas proceseve të punës;
- Të përdorë mjetet, veglat, pajisjet dhe makineritë në shërbime karrocërie;
- Të zbatojë dokumentacionin teknik për shërbimet e karrocërisë;
- Të përdorë katalogët për sigurimin e pjesëve të ndërrimit të karrocërisë;
- Të përpilojë listën e materialeve të nevojshme për punimet e karrocërisë;
- Të sigurojë bazën materialo-teknike për shërbimet e karrocërisë;
- Të vendosë mjetin në mënyre të sigurt në vendin e kontrollit dhe të punës për shërbimet e karrocërisë;
- Të kryejë stakimin e burimit të energjisë së automjetit para fillimit të procesit të punës.

### **Kontrolli paraprak në karrocërinë e automjeteve**

- Të kryejë kontrollet paraprake në karrocërinë e automjeteve;
- Të përdorë burime të ndryshme të informacionit për shërbimet në karrocëri;
- Të përcaktojë parregullsitë kryesore në karrocëri;
- Të kryejë kontrollet dhe matjet e nevojshme për shërbimet në karrocëri ;
- Të përcaktojë shkallën e dëmtimit të pjesëve të karrocërisë;
- Të përdorë instruksionet e prodhuesit për riparimin e karrocërisë;
- Të përcaktojë llojet e shasive sipas materialeve përbërëse dhe veçorive konstruktive të tyre;
- Të kryejë kontrollin paraprak dhe përcaktimin e parregullsive të aksesorëve në karrocëri;
- Të përdorë instrumentet dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese për kontrollin e aksesorëve të karrocërisë.

### **PUNIME (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi)**

#### **NË SHËRBIET E KARROCËRISË TË MJETEVE TË TRANSPORTIT**

##### **Të përgjithshme:**

- Të zbatojë standardet sipas manualeve të prodhuesit për shërbimet në karrocëri;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e çmontim/montimit të elementeve të karrocërisë;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e zëvendësimit të elementeve të karrocërisë;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e riparimit me prerje, ngjitje, bashkim, saldim, stukim dhe lyerje, me pajisjet dhe mjetet përkatëse.

##### **1. Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në shasinë e mjeteve të transportit**

- Të zbatojë radhën e punës për çmontimin dhe montimin e pjesëve xhenerike për realizimin e punimeve në shasinë e automjeteve;
- Të zbatojë procesin e kontrollit dhe matjes së shkallës së deformimit të shasisë;
- Të zbatojë hapat për drejtimin/riparimin e mundshëm të shasisë së deformuar;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e punimeve për lyerjen e pjesëve të riparuar të shasisë;
- Të përzgjedhë instrumentet dhe veglat e punës për lyerjen e pjesëve të riparuar të shasisë;
- Të përzgjedhë bojën dhe materialet e nevojshme për pastrimin dhe lyerjen e sipërfaqeve metalike të shasisë;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e shasisë së automjeteve;

- Të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet e kryera në shasi.

## **2. Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në kabinë**

- Të zbatojë procesin e kontrollit dhe përcaktimin e shkallës së dëmtimit të kabinës;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e punimeve të llamarinës në kabinë;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e punimeve të prerjes së pjesës së dëmtuar në kabinë;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e punimeve të saldimit në kabinë;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e punimeve të lidhjes ose bashkimit në kabinë;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e punimeve të stukimit dhe lyerjes së pjesëve të riparuar në kabinë;
- Të zbatojë procedurat e punimeve për zëvendësimin e kabinës së automjeteve;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet e kryera në kabinë.

## **3. Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në elementet e çmontueshme të kabinës**

- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e punimeve në dyert e automjeteve;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e punimeve në parafango;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e punimeve në mbulesën e motorit (kofano) dhe të bagazhit;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e punimeve në parakolp, mbrapakolp dhe maskarino;
- Të zbatojë procedurat e zëvendësimit të fenerëve, stopave, sinjaleve;
- Të zbatojë procedurat e riparimit/zëvendësimit të pasqyrave;
- Të zbatojë procedurat e zëvendësimit të xhamave të mjeteve të transportit;
- Të zbatojë procedurat e punimeve të riparimit/zëvendësimit të mekanizmit të ngritjes së xhamave;
- Të zbatojë procedurat e punimeve të riparimit/zëvendësimit të mekanizmit të fshirjes së xhamave;
- Të zbatojë procedurat e punimeve të zëvendësimit të gominave izoluese të kabinës;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet e kryera në elementët e çmontueshëm të kabinës.

## **4. Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në pjesët e brendshme të kabinës**

- Të zbatojë procedurat e zëvendësimit të kroskotit;
- Të zbatojë procedurat e zëvendësimit të airbag-ut;
- Të zbatojë procedurat e zëvendësimit të rripave të sigurimit;
- Të zbatojë procedurat e riparimit/zëvendësimit të sediljeve (ndenjësive);
- Të zbatojë procedurat e riparimit/zëvendësimit të veshjes së brendshme të automjetit;
- Të zbatojë procedurat e riparimit/zëvendësimit të aksesorëve të brendshëm;
- Të zbatojë procedurat e riparimit/zëvendësimit të baxhasë;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet e kryera në pjesët e brendshme të kabinës.

## **5. Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në aksesorët e karrocërisë dhe të kabinës**

- Të zbatojë procedurat e riparimit/zëvendësimit të bravave të automjetit;
- Të zbatojë procedurat e riparimit/zëvendësimit të dorezave të dyerve;

- Të zbatojë procedurat e riparimit/zëvendësimit të menteshave të dyerve;
- Të zbatojë procedurat e riparimit/zëvendësimit të fshirëseve të xhamave;
- Të zbatojë procedurat e riparimit/zëvendësimit të antenave;
- Të kryejë regjistrime në aksesoret e kabinës;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet e kryera në aksesoret e kabinës.

### **Stukimi, smerilimi, lyerja dhe luçidimi**

- Të përcaktojë pjesët e karrocërisë që do të smerilohen, stukohen, lyhen e luçidohen;
- Të përzgjedhë materialet e nevojshme për smerilim, stukim, lyerje dhe luçidim;
- Të përzgjedhë makineritë, pajisjet, veglat e duhura për smerilim, stukim, lyerje dhe luçidim;
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet, materialet për pastrimin kimik të sipërfaqes që do të smerilohet, stukohet, lyhet e luçidohet;
- Të zbatojë procesin teknologjik për përgatitjen e sipërfaqes së karrocërisë për lyerje;
- Të kryejë stukimin dhe smerilimin e sipërfaqes së karrocërisë që do të lyhet;
- Të vendosë dhe smerilojë astarin në sipërfaqet e karrocërisë që do të lyhet;
- Të pastrojë me solucion kimik sipërfaqen që do të lyhet;
- Të përzgjedhë nga katalogu bojën për lyerje;
- Të përgatisë furrën për procesin e lyerjes;
- Të realizojë izolimin e pjesëve që nuk do të lyhen;
- Të zbatojë procesin teknologjik për lyerjen e karrocërisë;
- Të zbatojë regjimin e duhur të procesit të pjekjes;
- Të realizojë montimin e pjesës së lyer të karrocërisë (nëse është çmontuar);
- Të identifikojë dhe eliminojë parregullsitë pas procesit të lyerjes;
- Të kryejë luçidimin e sipërfaqeve të karrocërisë, nëse është e nevojshme.

### **Shërbime mirëmbajtje të pjesëve të karrocërisë në mjetet e transportit**

- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes të pjesëve të karrocërisë;
- Të përdorë manualët e prodhuesit për shërbimet e mirëmbajtjes;
- Të përdorë materialet për mirëmbajtjen e pjesëve të karrocërisë;
- Të kryejë pastrime në pjesët e karrocërisë;
- Të kryejë regjistrime në pjesët e karrocërisë;
- Të realizojë shërbime të mirëmbajtjes në aksesoret e kabinës.

### **Sipërmarrje dhe edukim karriere**

- Të hartojë planin për hapjen e një biznesi për shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit;
- Të marrë informacion për nevoja dhe kërkesa të tregut për shërbime karrocërie;
- Të analizojë çmimet e tregut lidhur me materialet, pajisjet e punës, pjesët e këmbimit si dhe shërbimeve të kryera;
- Të llogarisë koston e materialeve të punës, pjesëve të këmbimit, si dhe shërbimeve të kryera;
- Të hartojë plane ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të zbatojë legjislacionin në fuqi për detyrimet tatimore;
- Të zbatojë kodin e punës;
- Të zbatojë standardet teknike në fushën e shërbimeve të karrocërisë;

- Të hartojë raportet periodike për shërbimet e kryera;
- Të përgatisë oferta për punimet/shërbimet që do të kryhen;
- Të regjistrojë ofertat dhe faturat për klientët për shërbimet e kryera;
- Të përcaktojë mënyrën e pagesës për shërbimet e kryera;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të nevojshëm;
- Të kryejë ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit;
- Të kryejë veprime me institucionet financiare;
- Të përzgjedhë mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të përdorë Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të menaxhojë burimet njerëzore për shërbime karrocierie në mjetet e transportit;
- Të përditësojë njohuritë për aplikimin e teknikave e reja në punë;
- Të kryejë trajnime të vazhdueshme sipas nevojës për rritje profesionale;
- Të marrë pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me ngritjen profesionale të tij;
- Të analizojë të dhënat e performancës së kolegëve dhe njësisë ku ai punon.

### **Komunikimi dhe etika profesionale**

- Të përcaktojë teknikat e komunikimit;
- Të këmbëjë informacione për problemet dhe të rejat e ditës;
- Të vlerësojë punën në grup;
- Të respektojë hierarkinë;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Të përdorë terminologjinë profesionale;
- Të zbatojë kodin e etikës;
- Të këmbëjë udhëzime/procedura me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës;
- Të zgjidhë ankesat;
- Të përdorë teknologjitë e reja të informimit dhe komunikimit;
- Të zbatojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në veprim dhe komunikim;
- Të organizojë procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.

### **Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit**

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë;
- Të zbatojë manualët e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas Standardit në fuqi;
- Të sigurojë ndriçimin dhe ajrimin e duhur të mjedisit të punës;
- Të sigurojë veshjen e përshtatshme për punë;
- Të mbajë pastër vendin e punës;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
- Të përdorë elementët e sinjalistikës të vendosura në mjediset e punës;
- Të sigurojë planin dhe procedurat e evakuimit në raste emergjence;

- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e përdorimit të pajisjeve të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH).
- Të vlerësojë rreziqet në ambientet me gaz, me energji elektrike, me materialet ndezëse etj.;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të ruajtjes, magazinimit dhe punimeve me lëngje të ndryshme (vaj, alkool, lëndë djegëse, bojë, solucionet kimike etj.);
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me vegla dhe pajisje nën tension;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë zhvendosjeve të ngarkesave dhe peshave të rënda;
- Të marrë masa për eliminimin e ndotjes së ambientit;
- Të zbatojë parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të zbatojë procedurat e duhura për ndarjen e mbetjeve sipas llojit dhe depozitimin e mbetjeve nga procesi i punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të përdorë në mënyrë racionale lëndët e para, veglat e këmbimit dhe të energjisë;
- Të zbatojë protokollet e duhura në raste pandemie.

## **KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME**

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin “Shërbime karrocierie”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, nxënësi do të përvetësojë kompetencat e përgjithshme të mëposhtme:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht dhe mendërisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të zbatojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.